



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Kërkesën e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të datës 09.03.2022, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për dhënien e vlerësimit profesional për largimin e drunjëve të tharë nga sheshi i qytetit apo rrugët tjera publike në kuadër të territorit të komunës , në këtë përbërje:

1. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, Kryesues
2. Azem Arifi, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
3. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë verifikimin e drunjëve të tharë në gjithë territorin e Komunës dhe të jap vlerësimin profesional se a duhet të largohen –prehen drunjët e thatë për shkak të vjetërsisë dhe se a paraqesin rrezik për kalimtarët sa herë që do të jetë e nevojshme varësisht nga nevojat dhe kërkesat e komunës apo kërkesat e parashtruara nga qytetarët për shkaqe të arsyeshme.
2. Komisioni ka mandat një vjeqar dhe për punën e tij e raporton Kryetarit të Komunës.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Inspeksion, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural , Drejtorati për Shërbime Publike ,Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.320-11802
Lipjan, më 11.03.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imr Ahmeti

